

VENDIME JASHTË MBLEDHJEVE TË BORDIT

Vendimi 2021-061

Data: 30.10.2021

Grupi punues për plotësimin e rregulloreve

- Bordi me shumicë votash miraton grupin punues për plotësimin e rregulloreve, prej 3 anëtarësh:
 - 1) Argjend Lecaj;
 - 2) Blearta Ukëhaxhaj;
 - 3) Lorik Haxhishabani.
- Grupi punues do të angazhohet për plotësimin e rregulloreve aktuale dhe hartimin e një strategjie për garat e kategorisë ROG.

Vendimi 2021-062

Data: 30.10.2021

Development Championship 2021

- Bordi me shumicë votash aprovon propozimet e selektorëve për tenistët që do të marrin pjesë në “Development Championship 2021” për grupmoshën U12 dhe U14, që do të mbahen ndërmjet datave 10-21 Dhjetor në Turqi.
- Në grupmoshën U12 do të marrin pjesë:
 - I) Lorik Haxhishabani- Selektor
 - II) Benita Selmanaj – Trajnere
 - III) Leara Muharremi – Teniste
 - IV) Ervin Doli – Tenist
- Në grupmoshën U14 marrin pjesë:
 - I) Arian Ibrahimimi – Selektor
 - II) Altea Hajrizi – Teniste
 - III) Meldina Mislimi – Teniste
 - IV) Salidin Rama – Tenist
 - V) Semi Kito – Tenist
- Shpenzimet e këtij aktiviteti mbulohe nga Tennis Europe/ITF.

Vendimi 2021-063

Data: 02.11.2021

Shtyhet Ceremonia e Laureatëve

- Bordi me shumicë votash merr vendim që ceremonia e laureatëve 2021 që ishte paraparë të organizohet më 19 dhjetor 2021 të shtyhet për 09 janar 2022 për shkak të pjesëmarrjes së tenistëve U12/U14 në Development Championships 2021.

Vendimi 2021-K01

Data: 08.11.2021

Krytari Hadërgjonaj merr vendim për rritjen e shpërblimeve të garave “Masters 2021” për kategorinë adult, me rreth 45% nga sa janë aktualisht në rregulloren financiare.

Ky vendim vlen vetëm për vitin 2021 si pasojë e sponsorizimit nga “BPB”.

Vendimi 2021-S01

Data: 08.11.2021

Sekretarja merr vendim që FTK të mbulojë shpenzimet e udhëtimit të pjesëmarrëseve të garave “Masters 2021” që udhëtojnë nga komuna të tjera nga ajo ku mbahet turneu. FTK do të kompensojë deri në njëzet euro (20€) për shpenzimet e udhëtimit.

Ky vendim do të aplikohet edhe brenda rregullores 03 për financat, procedura dhe rregullat dhe ne rregulloren 05 për garat zyrtare të FTK-së.